



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 156 Prot

Tiranë, më 25/11/2008

**VENDIM Nr. 15 dt. 20.11.2008**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.11.2008, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, mbi bazen e procesverbalit të mbledhjes dt. 20.11.2008, bashkangjitur,

**VENDOSI:**

**Të miratojë:**

1. Paketën e projekteve konservuese të hartuara nga ZAKPA Bylis.
  - a) Ndërhyrje konservuese në termën romake, pranë bazilikës C- Bylis.
  - b) Ndërhyrje konservuese në banesën romake, pranë bazilikës B-Bylis.
2. Paketën e projekteve të mirëmbajtjes të hartuara nga ZAKPA Apolloni
  - a) Projekt për evidentimin dhe pastrimin e mujt të Akropolit.
  - b) Projekt për evidentimin dhe ekspozimin e tempullit në kuotën 104.
  - c) Projekt për pastrimin e sterës antike të njohur si “Pusi i Gjoncës”
  - d) Punime restauruese dhe rrethimi i termave antike në Apolloni.
3. Ambiente për vendosjene e biletarisë në kalanë e Gjirokastrës.
4. Projekti i konservimit të mozaikut të bazilikës në “Tepe”, Elbasan.
5. Projekti i punimeve konservuese e restauruese në bazilikën e Tiranës.
6. Paketën e projekteve të mirëmbajtjes të hartuara nga DRKK, Tiranë.
  - a) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Ura e Brarit, Dajt, Tiranë
  - b) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Brarit, Dajt, Tiranë
  - c) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Gjon Pagëzorit, Derven, Krujë.
  - d) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Shën Mërisë, Mamurras.
  - e) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Kisha e Shën Kollit, Krutje.
  - f) Punime konservuese dhe mirëmbajtje Ura e Tabakëve, Tiranë
7. Të miratojë projekt idenë fituese të Projektit për Rehabilitimin e sheshit “Skënderbej”, me kushtet e mëposhtme:
  - a) Të mos lejohet ndërtimi i 2 ndërtesave të reja përkatësisht në aksin e Bulevardit “Zogu i Parë”, dhe midis Muzeut Kombëtar dhe Bankës së Shqipërisë
  - b) Shtrimi i sheshit të bëhet me pllakat tradicionale, me të cilat janë shtruar edhe akset që nga Universiteti i Tiranës deri tek Stacioni i Trenit.
  - c) Pendenca e sheshit të propozuar (pjerrësia), të mos kalojë 1%.

8. Të miratojë heqjen e statusit monument kulture banesës së Hutajve, Tiranë, e cila nuk ekziston
9. Projektin për disa restaurime të objekteve në muzeumet kombëtare Onufri dhe Etnografik, Berat.
10. Projekt idenë për ikonat e muzeut Onufri, Berat në lidhje me dokumentimin multispektral në ed-xrf, makro dhe mikro fotografike për restaurimin dhe ruajtjen e tyre.(Pas përfundimit të analizave, është i detyrueshëm botimi i rezultateve.)

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturere për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
YLLIPANGO**



**Sekretari i KKR  
Besim Lila**